



Prishtinë: 10.12.2020

Kodi i ZRRE-së: V_

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2107_10_20**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **03.12.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 10.12.2020 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin **L. S. K. (N.P.N" AEG")** nga Komuna e Dragashit, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRRE/DMK_V_2107_10_20 i datës 30.10.2020.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 03.12.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-s, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë, ndaj konsumatorit L. S. K. (N.P.N" AEG") nga Komuna e Dragashit lidhur me kundërshtimin ndaj korrigjimit plotësues. Në ankesë KESCO ka theksuar se korrigjimi plotësues i datës 08.03.2018 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, respektivisht nenit 4.11.1 të Kodit të Matjes. Në ankesë theksohet se sipas procesverbalit të kalibrimit ku theksohet se njehsori ka të djegur sistemin e fazës R dhe S. KESCO në ankesë ka theksuar se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike i bërë nga DMK në ZRRE nuk është i drejtë dhe i saktë, pasi që shpenzimi në vazhdimësi është rritur, dhe se shihet qartë se sipas shpenzimit të periudhës 01/2018 – 12/2018 dhe 01/2019 – 12/2019 rezulton se konsumatori me njehsorin e ri ka pasur shpenzim më të lartë. KESCO gjithashtu ka theksuar se te konsumatori ka hasur në shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike. Në ankesë KESCO ka theksuar se konsumatori NTP "AEG Sharr" L. S. K. në shifrën DPZ – 9038533 ka mbyllur veprimtarinë komerciale dhe nuk punon dhe se i njëjti ka shifër tjetër DPZ – 9071170 dhe se shpenzimi i tij është mjaft i lartë. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2107_10_20, i datës 30.10.2020, për konsumatorin NTP "AEG Sharr" L. S. K. me shifër DPZ – 9038533.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.12.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se korrigjimi plotësues i datës 08.03.2018 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, respektivisht nenit 4.11.1 të Kodit të Matjes, Bordi i ZRRE-



së thekson se është e vërtetë se proceduralisht KESCO ka vepruar bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas se cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët komercial përfshin periudhën një vjeçare, por duhet theksuar se në rastin e konsumatorit korrigjimi shtesë nr.51501DPZ9038533 në vlerë **9,416.32€**, në asnjë rast nuk përputhet me shpenzimet e energjisë elektrike të konsumatorit, dhe kjo vërtetohet me krahasimin e shpenzimeve të energjisë elektrike.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se sipas procesverbalit të kalibrimit ku theksohet se njehsori ka të djegur sistemin e fazës R dhe S, Bordi i ZRRE thekson se është poashtu e vërtetë se me datë 20.01.2018 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes së njehsorit elektrik nr.45813639 ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori pjesën kyçëse e ka të djegur. Në brendi të njehsorit komisioni ka vërejtur se: sistemet e fazave R dhe S janë të djegura dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike për **66.66%** më pak. Por që poashtu Bordi thekson se sipas Rregullave dhe Procedurave në fuqi, procesverbali i kalibrimit për shqyrtimin e saktësisë së matjes nuk duhet të merret si provë meritore pa u analizuar të gjitha shkresat e lëndës, analizim të shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit dhe procesverbale tjera.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike i bërë nga DMK në ZRRE nuk është i drejtë dhe i saktë, pasi që shpenzimi në vazhdimësi është rritur, dhe se shihet qartë se sipas shpenzimit të periudhës 01/2018 – 12/2018 dhe 01/2019 – 12/2019 rezulton se konsumatori me njehsorin e ri ka pasur shpenzim më të lartë, Bordi i ZRRE thekson se krahasimi i shpenzimit të energjisë elektrike është indikator mjaft i rëndësishëm gjatë shqyrtimit të lëndëve të konsumatorit. Bordi i ZRRE thekson se ka analizuar shpenzimin e përgjithshëm të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik dhe ka vërejtur se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Bazuar në analizën së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik nr.45813639 dhe njehsorin e ri elektrik nr.69074331 për periudha të njëjta kohore, Bordi ka konstatuar se ka ndryshim të shpenzimeve përkatësisht ka rritje të shpenzimit. Sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.45813639 për periudhën 01/2014 deri në periudhën 12/2014 është **2,276 kWh/muaj**, periudhën 01/2015 deri në periudhën 12/2015 është **2,828 kWh/muaj**, periudhën 01/2016 deri në periudhën 12/2016 është **3,044 kWh/muaj** si dhe periudhën 01/2017 deri në periudhën 12/2017 është **3,649 kWh/muaj** kurse me njehsorin e ri elektrik nr.69074331 periudha 01/2018 deri në periudhën 12/2018 është **4,259 kWh/muaj**, periudha 01/2019 deri në periudhën 12/2019 është **7,720 kWh/muaj** si dhe periudha 01/2020 deri në periudhën 10/2020 është **5,602 kWh/muaj**. Duhet të theksohet se konsumatori për periudhën 08/09/10/2020 nuk ka fare shpenzim të energjisë. Bordi i ZRRE bazuar në krahasimet e bëra konstaton se konsumatori ka ndryshim në shpenzimet e regjistruara me dy njehsorët elektrik dhe se rritjen me të madhe të shpenzimit e ka në periudhën 2019 me njehsorin nr.55469715. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka konstatuar se shpenzimi i energjisë elektrike i vitit 2018 me njehsorin nr.55469715 krahasuar me një vit mbrapa, pra për periudhën të cilën KESCO e ka ngarkuar me korrigjim plotësues nuk paraqet rritje të madhe të madhe të shpenzimit të energjisë elektrike, e cila do të kishte rezultuar sipas procesverbalit për shqyrtim të njehsorit elektrik nr.org.02, nr.1514 të datës 20.01.2018. Pra Bordi i ZRRE konstaton se në rastet kur eliminohen defektet e njehsorit elektrik të cilat rezultojnë në mos regjistrimin e saktë dhe të plotë të energjisë elektrike, atëherë me rastin e ndërrimit të tij apo me rastin e eliminimit të saj do të duhej të refleктоhej ai shpenzim i energjisë elektrike, e që në rastin e konsumatorit me rastin e ndërrimit të njehsorit elektrik ai shpenzim i energjisë elektrike nuk është reflektuar në atë masë sa ka theksuar KEDS përmes procesverbaleve të kalibrimit. Bordi i ZRRE thekson se ka analizuar kilovatorët - kWh e korrigjuar nga ana e KESCO, dhe se sipas korrigjimit në fjalë i bie që vlera reale e cila është faturuar



nga KESCO për periudhën 12/2016 deri ne periudhën 11/2017 është **11,007 kWh/muaj** e që kjo nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit, e të cekur më lartë as para kontestit e as pas kontestit.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se punëtorët e autorizuar të KEDS te konsumatori kanë hasur në shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE ju thekson se bazuar në dispozitat e nenit 4 paragrafi 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, theksohet: *“Çdo ankesë ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale dhe vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 61 të Ligjit për Energji Elektrike, si dhe me dispozitat ligjore siç përcaktohen në Kapitullin XXVI të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Veprat Penale Kundër Shërbimeve Komunale, ku përfshihet edhe vjedhja e energjisë termike (ngrohja qendrore) janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente, andaj këto ankesa ose konteste nuk trajtohen në këtë rregull”*, Andaj ZRRE potencon se nuk ka kompetencë që të shqyrtoi ankesat që kanë të bëjnë me shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, dhe kompetente për zgjidhjen e kësaj ankesë është vetëm gjykata. Gjithashtu thekson se çështja e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike nuk ndërlidhet fare me rastin e konsumatorit, pasi që natyra e ankesës së konsumatorit është kontestim korrigjimi shtesë i bërë me datë 08.03.2018, dhe se sipas KEDS-it shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë elektrike ka ndodhur diku në vitin 2020, andaj edhe nuk mund të merret si provë kjo çështje në shqyrtimin e ankesës së konsumatorit, e kur kësaj i shtojmë edhe faktin se në periudhën e shqyrtimit të ankesës ky fakt nuk ka qenë relevant me rastin.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO se konsumatori NTP “AEG Sharr” L. S. K. në shifrën DPZ – 9038533 ka mbyllur veprimtarinë komerciale dhe nuk punon dhe se i njëjti ka shifër tjetër DPZ – 9071170 dhe se shpenzimi i tij është mjaft i lartë, Bordi i ZRRE thekson se kjo çështja fare nuk ka të bëjë me ankesën e konsumatorit, pasi që ankesa e konsumatorit lidhet me shifrën DPZ – 9038533 dhe jo me shifra tjera, andaj edhe kjo nuk është relevante me rastin.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij ka ofruar procesverbalin nr.2261721 të datës 25.11.2020, si dhe disa fotografi të pikës matëse, për të vërtetuar argumentet e KEDS/KESCO, por që Bordi i ZRRE ka konstatuar se prova e ofruar nuk është provë e cila duhet të merret parasysh pasi nuk ka të bëjë me ankesën e konsumatorit për korrigjimin shtesë, dhe nuk ndërlidhet me rastin në fjalë, andaj konstaton se vendimi i DMK-së në ZRRE si organ i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.12.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit **L. K. (N.P.N" AEG")** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.